

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës–Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Hajnalka Veronika Karpati, kryetare, Xhevdet Abazi, gjyqtar raportues dhe Abdullah Ahmeti, si anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore të EULEX-it, Anna Malmstrom, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit **NV**, nga fshati i , Komuna e , për shkak të veprave penale vrasje e rëndë, nga neni 147 par.1 nën par. 4 të KPK, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim ose në shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK, duke vendosur përkitazi me ankesat e të dëmtuarve **DB**, **DO**, **JK** dhe mbrojtësve të të akuzuarit, av.Flamur Kelmendi dhe Gëzim Kollqaku, nga Peja, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, P.nr.68/2012, të dt.04.07.2012, në seancën e kolegjit të mbajtur konformë dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, më datë 19.09.2013, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pa bazuara ankesat e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar **DO**, të dëmtuarve **DB**, **JK** dhe mbrojtësve të të akuzuarit **NV**, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, P.nr.68/2012, të dt. 04.07.2012, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, P.nr.68/2012, të dt.04.07.2012, i akuzuari **NV**, është shpallur fajtor për shkak të veprave penale vrasje e rëndë, nga neni 147 par.1 nën par.4 të KPK, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim ose në shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK, dhe pasi më parë i është përcaktuar për veprën e parë penale dënimi me burg në kohëzgjatje prej 15(pesëmbëdhjetë)vite e 6(gjashtë)muaj, dhe veprën e dytë penale, dënim me burg në kohëzgjatje prej

1(një)viti burgim, me aplikimin e dispozitave të nenit 71 të KPK, për shqiptimin e dënimit unik është gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 16(gjashtëmbëdhjetë)vite, në të cilin dënim i ka llogaritur kohën e kaluar në paraburgim prej dt.21.10.2011, e tutje. Të akuzuarin e ka detyruar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 400(katërqind)Euro, si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 100(njëqind)Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Ndaj të akuzuarit po ashtu ka shqiptuar dënimin plotësues duke konfiskuar armën-pushkë automatike të tipit "AK-47", me numër serik XXXXXXXX, dy karikator të pushkës në fjalë dhe 36 copë fishek të kal.7.62x39mm, si mjet me të cilin është kryer vepra penale.

Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike, i ka udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesa kanë paraqitur:

-I dëmtuari **DO**, për mes përfaqësuesit të autorizuar av.Ljubomir Pantoviq, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim me burg më të lartë.

-E dëmtuara **JK**, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim me burg më të lartë.

-I dëmtuari **DB**, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim me burg më të lartë.

-Mbrojtësit e të akuzuarit, av.Flamur Kelmendi dhe av.Gëzim Kollqaku, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim me i butë me burgim.

Gjykata e Apelit, bazuar në kompetencën funksionale, në bazë të vendimit të kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, me nr.2013 OPEJ.0386-0001, në këtë çështje penalo juridike, vendosi në kolegjin e përbërë prej një gjyqtari të EULEX-it- kryetar i kolegjit dhe dy gjyqtarëve vendor-anëtarë të kolegjit.

Gjykata e Apelit e Kosovës, seancën e kolegjit e mbajti konformë dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK-së, për të cilën në mënyrë të rregullt janë njoftuar Prokurori i Apelit, i akuzuari dhe mbrojtësit e tij, të dëmtuarit, ndërsa në seancë nuk prezantoi vetëm e dëmtuara **JK**, edhe pse ishte njoftuar në mënyrë të rregullt. Nga Prokuroria e Apelit-Zyra e Prokurorisë së EULEX-it, prezantoi prokurori Claudio Pala, i cili ngeli në tërësi pranë deklarimit me shkrim të dt.15.05.2013, duke propozuar që ankesat e mbrojtësve të të akuzuarit, si dhe ato të dëmtuarve, të refuzohen si të pa bazuara, ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë të vërtetohet.

Të dëmtuarit **DO** dhe **DB**, si dhe përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit **DO**, av.Ljubomir Pantoviq, ngelën në tërësi pranë të të thënave si në ankesë, duke propozuar ndryshimin e aktgjykimit të shkallës së parë dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ashpër me burgim. Mbrojtësit e të akuzuarit, av.Flamur Kelmendi dhe av.Gëzim Kollqaku, po ashtu ngelën në tërësi pranë pretendimeve si në ankesë, duke propozuar që ankesat e të dëmtuarve të refuzohen, ndërsa të aprovohet ankesa e të akuzuarit, kuptohet e paraqitur përmes mbrojtësve të të akuzuarit, dhe të akuzuarit të i shqiptohet një dënim dukshëm më i butë me burgim. I akuzuari në tërësi përkrahu fjalën e mbrojtësve të tij, duke shprehur keqardhje për atë që ka ndodhur ditën kritike.

Prokurori i Apelit-Zyra e Prokurorisë së EULEX-it, me parashtrësën e saj, PPA/I.nr.89/2013, të dt.15.05.2013, ka propozuar që ankesat e mbrojtësve të të akuzuarit, si dhe ajo e të dëmtuarës **JK**, të refuzohen si të pa bazuara, ndërsa ato të dëmtuarve **DB** dhe **DO**, të hudhen si të paafatshme, gjegjësisht edhe këto të refuzohen si të pa bazuara, ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes penale, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në ankesa, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit, të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt konformë dispozitës së nenit 394 të KPPK-së, dhe konstatoi se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu, as gjendja e fakteve nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase as me ankesë nuk ka mundur të kundërshtohet ngase i akuzuari në seancën e shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore, përkritazi me vendimin për dënim.

Duke shqyrtuar çështjen përkritazi me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore përkritazi me këtë bazë ankimore nuk qëndrojnë. Me ankesat e përfaqësuesit të palës së dëmtuar, si dhe vetë të dëmtuarve, theksohet se gjykata e shkallës së parë, rrethanat lehtësuese të cilat i ka përcaktuar nuk i ka vlerësuar drejtë, gjegjësisht të njëjtat i ka mbivlerësuar, e po ashtu disa nga to edhe as që është dashur të konsiderohen si rrethana lehtësuese, e për çka pastaj si rezultat i vlerësimit të tillë, të akuzuarit i ka shqiptuar dënim shumë të butë, dënim ky i cili nuk është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të të

akuzuarit, me motivin e veprës penale, peshën e veprës penale dhe as shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale në fjalë. Në ankesat e të dëmtuarve, pretendimet e cekura më lartë arsyetohen me faktet se duke pasur parasysh brutalitetin e shprehur nga i akuzuari, pastaj se tani i ndjeri **K**, është vrarë në tokën e vet, se në dy të dëmtuarit tjerë është shtënë pas shpine-para në momentin ku të dëmtuarit në fjalë po largoheshin nga vendi i ngjarjes, se vrasja ka qenë e planifikuar më parë nga i akuzuari, se në të dëmtuarit është shtënë disa herë më radhë, pastaj gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka konsideruar si rrethana lehtësuese pranimin e veprës penale, pendimin e të akuzuarit, sjelljen e viktimave, sjelljet provokative të të ndjerit-nxjerrja e armës duke shtënë dy herë në të akuzuarin, mosha e të akuzuarit dhe mosmarrëveshjet lidhur me shitblerjen e tokës, rrethana këto të gjitha të cilat nuk është dashur të merren parasysh për çka gjykata e shkallës së parë gabimisht ka shqiptuar dënim dukshëm më të butë me burgim, sesa që është dashur ti shqiptohet të akuzuarit. Ndërsa në ankesën e mbrojtësve të të akuzuarit, theksohet se gjykata e shkallës së parë, i ka konstatuar shumicën e rrethanave lehtësuese, mirëpo, të njëjtat nuk janë vlerësuar realisht e as në masë të duhur, për çka sidomos është dashur të merret parasysh rrethana se i akuzuari ka vepruar në rrethana të aftësisë së zvogëluar mendore, si pasojë e provokimeve nga tani i ndjeri dhe të dëmtuarve, pastaj se është dashur të merren parasysh pranimi i veprës penale, pendimi, se në të akuzuarin është shtënë më parë nga tani i ndjeri **K**, gjendja familjare e të akuzuarit-se i njëjti është mbajtës i vetëm i familjes, rrethana këto të cilat domosdo kushtëzojnë shqiptimin e një dëmi shumë më të butë me burgim, sesa dënimi i shqiptuar në aktgjykimin e ankimuar.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit, kundër të akuzuarit, në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse ka vlerësuar të gjitha rrethanat sikur që parashihet me dispozitat e nenit 73 të KPK, gjegjësisht kodit të mëparshëm në fuqi, neni 64 i KPK, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Kështu që në ankesa të paraqitura nuk theksohet ndonjë rrethanë tjetër e karakterit posaçërisht lehtësuese e cila do të ndikonte që të akuzuarit, ti shqiptohet dënim më i butë, por vetëm përsëriten shumica e rrethanave lehtësuese të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, me përjashtim të rrethanave lehtësuese që janë kryesisht të natyrës familjare, por që duke pasur parasysh natyrën dhe rrezikshmërinë e veprës penale janë pa ndikim të drejtpërdrejt që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë se sa dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë. Po ashtu edhe në ankesat e të dëmtuarve nuk theksohet ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese të cilat do të ndikonin që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ashpër, sikurse që pretendohet nga përfaqësuesi i palës së dëmtuar, por edhe vetë të dëmtuarit, por ceken rrethana që gjykata e shkallës së parë, i ka përfshirë në mënyrë të përgjithësuar e duke marrë parasysh shprehimisht si rrethanë rënduese edhe intensitetin e lëndimeve trupore të të dëmtuarit, ndërsa sa i përket rrethanave lehtësuese, pretendimet ankimore në këtë drejtim nuk qëndrojnë, ngase rrethanat

në fjalë në aktgjykimin e ankimuar jo vetëm që drejtë janë konstatuar, por të njëjtat edhe janë vlerësuar realisht.

Megjithatë, Gjykata e Apelit ndryshon rrethanat lehtësuese sikurse janë vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë duke përjashtuar me sa vijon: mosha e vjetër pasi që mosha 53 vjeç nuk është moshë që mund të konsiderohet lehtësuese, fyerja e pretenduar ndaj **MV** pasi që e njëjta nuk është provuar dhe së fundi, mosmarrëveshja e përshkallëzuar rreth pronës së tokës fqinje pasi që nxjerrja e armës për të zgjidhur mosmarrëveshjen nuk duhet të inkurajohet.

Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha këto rrethana, rrethanat e cekura në aktgjykimin e ankimuar, rrethanat e rastit konkret, mënyrën se si është zhvilluar ngjarja kritike-pra përveç rrethanave tjera të konstatuara, pastaj se i akuzuari ka shkuar në vendin e ngjarjes i armatosur me pushkë automatike, por njëkohësisht ka qenë edhe i provokuar ngase në të është shtënë nga pala e dëmtuar, shkaktimi i pasojës së ndaluar-ku pasi privon nga jeta një person, dy të dëmtuarve tjerë u shkakton lëndime të rënda trupore dhe atë në momentin kur dy të dëmtuarit, ishin duke ikur nga vendi i ngjarjes, pra në të dëmtuarit është shtënë nga prapa, rezulton se dënimi i cili i është shqiptuar të akuzuarit, është i drejtë dhe i ligjshëm, është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe në shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, pastaj gjithashtu është në funksion të preventivës gjenerale, por edhe individuale dhe se me dënimin e shqiptuar pa dyshim që do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë sipas dispozitave të nenit 41 të KPK.

Nga sa u tha më latë e konformë dispozitës së nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Përgatitur në gjuhën shqipe, gjuhë e autorizuar.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.1400/2012, të dt.19.09.2013

Zyrtarja ligjore,

Anna Malmstrom

Anëtarët e kolegjit,

1.Xhevdet Abazi

2.Abdullah Ahmeti

Kryetarja e kolegjit,

Hajnalka Veronika Karpati,